

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Tregtare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	IV
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësit e lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Valbon Mulaj, Prof. Asst. Dr. Luljeta Plakolli – Kasumi
Detajet kontaktuese:	valbon.mulaj@uni-pr.edu , luljeta.plakolli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>E Drejta Tregtare është lëndë obligative në semestrin e shtatë (semestrin dimëror), me fond javor të orëve mësimore (dy orë ligjërata dhe një orë ushtrime), me gjithsej gjashtë kredi.</p> <p>E Drejta Tregtare ka për synim ofrimin e njohurive të përgjithshme për të drejtën tregtare.</p> <p>Lënda E Drejta Tregtare ka për qëllim që studentët, pas përfundimit të lëndës, të jenë në gjendje të zbatojnë në praktikë njohuritë e fituara për të drejtën tregtare.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi kryesor i lëndës, konsiston në arritjet kulturore të analizave teorike dhe praktike të modeleve me të dobishme dhe më avancuese të tregtisë të një vendi. Më tutje, lënda synon përgatitjen më adekuate dhe më të plotë të studentëve të drejtësisë për t'i përballur me sukses kërkesat, nevojat dhe sfidat e tregut të dijes përkitazi me sferat, degët dhe disiplinat e ndryshme shkencore, që bëjnë pjesë drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt më të drejtën tregtare të ne dhe gjetiu.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të lëndës, studentët duhet të jenë të aftë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. të kanë njohuri të përgjithshme për të drejtën tregtare; 2. të kuptojnë rolin e shtetit në rregullimin e të drejtës tregtare; 3. të kuptojnë mënyrën e themelimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare; 4. të analizojnë dhe krahasojnë legjislacionin

	<p>vendor me vendet e zhvilluara;</p> <p>5. të zbatojnë ligjin për shoqëritë tregtare dhe ligjet e tjera në praktikë;</p> <p>6. të zgjidhin konteste tregtare në Gjykatën komerciale;</p> <p>7. të zgjidhin konteste tregtare me ndërmjetësim dhe arbitrazh.</p>
--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

G

Kontributi më ngarkesën diturore të studentit (që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në terren	1	1/15	15
Kollokfiime, seminare	1	1/10	10
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1/1	5
Projektet, prezantimet, etj.	10	1/1	10
Totali	6 ECTS	Total	150

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Prezantimi i temës në ligjërata bëhet në mënyrë verbale, përmes Power Point-it, diskutime interaktive, ndarjeve në grupe dhe zgjidhje të rasteve praktike.</p> <p>Në çdo fillim ore do të ketë: përsëritje nga tema e kaluar për të filluar temën tjetër; prezantime të hulumtimeve individuale dhe grupore; analiza për lëndën.</p>
-------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Metodat e vlerësimit:	<p>Për vlerësimin e studentëve, mësimdhënësi do të ketë në konsideratë këto kritere.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi i vazhdueshëm:</u></p> <p>Pikët në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi individual.....5 pikë; - Prezantimi dhe puna grupore.....5 pikë; - Punimi seminarik.....10 pikë;
------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

	<ul style="list-style-type: none"> - Testi i parë 40 pikë; - Testi i dytë 40 pikë. <p>Studentët që arrijnë rezultat pozitiv përmes vlerësimit të vazhdueshëm, lirohen nga provimi.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi në provimin final:</u></p> <p>Studentët që nuk arrijnë sukses përmes vlerësimit të vazhdueshëm, hyjnë në provimin final. Provimi final ka gjithsej 80 pikë, kurse 20 pikët e cekura më lartë arrihen nga: Prezantimi individual - 5 pikë; Prezantimi dhe puna grupore - 5 pikë; Punimi seminarik - 10 pikë. Të gjitha këto pikë numërohen dhe transferohen në provimin final.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Mehdi J. Hetemi: "E drejta me njohuritë themelore të drejtës afariste", Prishtinë, 2006.</p> <p>Armand Krasniqi: "E drejta tregtare", Pejë, 2021.</p>
Literatura shtesë:	<p>Alban Alimema: "Grupet e Shoqërive tregtare", Tiranë, 2022. Disertacion për Mbrojtjen e Gradës Shkencore "Doktor" në Universitetin Shtetëror të Tiranës.</p> <p>Fatri Islamaj: "Shoqëritë përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri", Tiranë, 2021. Disertacion për Mbrojtjen e Gradës Shkencore "Doktor" në Universitetin Shtetëror të Tiranës.</p> <p>Artan Hajdari: "Natyra Juridike e Administrimit të shoqërive tregtare", Tiranë, 2019. Disertacion për Mbrojtjen e Gradës Shkencore "Doktor" në Universitetin Shtetëror të Tiranës.</p> <p>Adnan Jashari: "E Drejta Afariste (Kontraktore) (Business (Contract) Law)", Tetovo, 2016.</p> <p>Adnan Jashari: "Subjektet e së drejtës afariste", Tetovë, 2009.</p> <p>Vilim Gorenc: "Bazat e së drejtës tregtare statusore dhe kontraktore", Prishtinë, 2006.</p> <p>Valbon Mulaj: "The advantages and disadvantages of arbitration in relation to the regular courts in Kosovo." Hungarian Journal of Legal Studies 59, no. 1 (2018): 118-133.</p> <p>Valbon Mulaj: "National Legal Regulation of Arbitration in the Republic of Kosovo." Int'l Bus. LJ (2015): 15-38.</p> <p>Materiale të përgatitura ose të përmbledhura nga profesori i lëndës, dhe të dorëzuara më kohë, që lejon hapësirë të mjaftueshme për studim përpara</p>

	<p>ligjëratës përkatëse. Raste të përgatitura nga Profesori.</p> <p><i>Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës:</i> <i>Ligji për Shoqëritë Tregtare.</i> <i>Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.</i> <i>Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit.</i> <i>Ligji për Investime të Qëndrueshme.</i> <i>Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.</i> <i>Ligji për Markat Tregtare.</i> <i>Ligji për Gjykatën Komerciale.</i> <i>Ligji për Ndërmjetësimin.</i> <i>Ligji për Arbitrazhin.</i> <i>Ligji për Falimentimin.</i> <i>Ligji për Ndërmarrjet Publike.</i> <i>Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.</i> <i>Ligji për Dizajnin Industrial.</i> <i>Ligji për Markat Tregtare.</i> <i>Ligji për Patentat.</i> <i>Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<p>Prezantimi i lëndës, i literaturës, si dhe i rregullave.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vështrime të përgjithshme për lëndën: E Drejta Tregtare
<i>Java e dytë:</i>	<p>Tema: Njohuri të përgjithshme për lëndën: E Drejta Tregtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejta tregtare statusore; • E drejta tregtare kontraktore; • Parimet e të drejtës tregtare; • Burimet formale dhe materiale të të drejtës tregtare; • Degët e të drejtës.
<i>Java e tretë:</i>	<p>Tema: Njohuri themelore për rolin e shtetit në fushën e të drejtës tregtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Baza ligjore në fuqi për organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare; • Rregullimi i marrëdhënieve të punës; • Mbrojtja e konkurrencës; • Mbrojtja e konsumatorit; • Investimet e huaja.
<i>Java e katërt:</i>	<p>Tema: Format e shoqërive tregtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Biznesi individual;

	<ul style="list-style-type: none"> • Ortakëria e përgjithshme; • Ortakëria e kufizuar; • Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar; • Shoqëria aksionare;
<i>Java e pestë:</i>	Tema: E drejta tregtare kontraktore <ul style="list-style-type: none"> • Kontrata si burim i detyrimeve; • Formimi i kontratës (oferta dhe pranimi i ofertës); • Kushtet e kontratës; • Forma e kontratës.
<i>Java e gjashtë:</i>	Tema: E drejta tregtare kontraktore <ul style="list-style-type: none"> • Pavlefshmëria e kontratave; • Mjetet për sigurimin e kontratës.
<i>Java e shtatë:</i>	Testi I
<i>Java e tetë:</i>	Tema: Kontratat kryesore në lëmin e ekonomisë <ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e kontratave në ekonomi; • Llojet e kontratave.
<i>Java e nëntë:</i>	Tema: E drejta pronësore <ul style="list-style-type: none"> • Prona dhe blerja e pronës; • Pronësia dhe lizingu i pronës se paluajtshme.
<i>Java e dhjetë:</i>	Tema: Punët bankare dhe letrat me vlerë <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i bankave; • Rregullimi ligjor; • Marrëdhëniet mes bankës dhe klientit; • Llojet e letrës me vlerë (kambiali, çeku, aksionet etj.); • Rëndësia e letrave me vlerë.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Tema: Zgjidhja e kontesteve tregtare në Gjykatën komerciale
<i>Java e dybëdhjetë:</i>	Tema: Zgjidhja e kontesteve tregtare me ndërmjetësim
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Tema: Zgjidhja e kontesteve tregtare me arbitrazh
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Testi II
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Tema: Përmbledhje e lëndës.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Student-i/ja duhet të jetë i/e ndërgjegjsh-ëm/me dhe të respektojë institucionin, statutin dhe aktet e tjera ligjore të UP-së; duhet të respektojë orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve; të marrë pjesë dhe të jetë aktiv në orën mësimore; student-i/ja është i/e obliguar ta posedojë më vete ID-kartelën në ligjëratat, testet dhe provimin final; gjatë hartimit të punimeve seminarike, student-i/ja duhet t'u përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student/e. Prandaj, studentët duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale.

Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet sipas akteve ligjore të UP-së.

